



VENDIM

Nr. 5 Datë 20.01.2010

PËR

**NDRYSHIMIN E LICENSËS NR.16, SERIA PV04P, LËSHUAR ME
VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONEREVE TË ERE-S, NR.39,
DATË 22.07.2004 PËR SHOQËRINË “WTS ENERGJI” SH.P.K TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 19, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, nenit 15 pika 2 gërma “c” të “Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshem dhe rinovimit të liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108, datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 20.01.2010, mbasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “WTS Energji” sh.p.k, për ndryshimin e liçensës Nr.16, Seria PV04P, për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.39, datë 22.07.2004, për shoqërinë “WTS Energji” sh.p.k, të ndryshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 26, datë 09.04.2009,

Dhe konstatoi se:

- Fillimi i procedurave për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “WTS Energy” sh.p.k ka nisur me marrjen e vendimit Nr.82 Datë 04.11.2009
- Janë paraqitur ne përputhje me rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshem dhe rinovimit të liçensave”:
 - Informacioni me shkrim ku janë shpjeguar arsyet e kërkesës për modifikimin e liçensës (neni 15, pika 4, gërma “a”);
 - Vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të liçensuarit të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar ndryshim liçensave (neni 15, pika 4, gërma “b”).

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve,

Vendosi:

1. Ndryshimin e liçensës Nr.16, seria PV04P, lëshuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, Nr.39, datë 22.07.2004 për shoqërinë “WTS

Energji” sh.p.k të ndryshuar me Vendimin e Bordit të Komisionereve Nr. 26, datë 09.04.2009, duke hequr nga lista e impianteve gjenerues ne Aneksin A, HEC-in Selce.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE
Bordi i Komisionereve



-
2. WTS Energy sh.p.k të vazhdojë të operojë HEC Selcë deri në liçensimin e personit në pronësi të të cilit kalon HEC Selcë.
 3. Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të Komisionereve të ERE-s si dhe të informojë personin në pronësi të cilit ka kaluar HEC Selcë lidhur me dokumentacionin që nevojitet për liçensim.

Ky vendim hyn në fuqi menjehere.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Kryetari i ERE-s
Bujar Nepravishta

